



COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS

© Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2012. Ky përkthim u krye me mbështetje të Fondit të Mirëbesimit të të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës (www.coe.int/humanrightstrustfund). Ai nuk është detyrues për Gjykatën. Për informacione të mëtejshme shiko të dhënat e plota për të drejtën e autorit në fund të këtij dokumenti.

© Council of Europe/European Court of Human Rights, 2012. This translation was commissioned with the support of the Human Rights Trust Fund of the Council of Europe (www.coe.int/humanrightstrustfund). It does not bind the Court. For further information see the full copyright indication at the end of this document.

© Conseil de l'Europe/Cour européenne des droits de l'homme, 2012. La présente traduction a été effectuée avec le soutien du Fonds fiduciaire pour les droits de l'homme du Conseil de l'Europe (www.coe.int/humanrightstrustfund). Elle ne lie pas la Cour. Pour plus de renseignements veuillez lire l'indication de copyrights/droits d'auteur à la fin du présent document.

SEKSIONI I KATËRT

ÇËSHITJA K.U. K. FINLANDËS

(Kërkesë nr. 2872/02)

Vendim

STRASBURG

2 DHJETOR 2008

PËRFUNDIMTAR

02/03/2009

Ky vendim mund t'i nënshtrohet rishikimit editorial.

Në çështjen K.U. k. Finlandës,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), me trup gjykues të përbërë nga:

Nicolas Bratza, *Kryetar*,
Lech Garlicki,
Giovanni Bonello,
Ljiljana Mijović,
David Thór Björgvinsson,
Ján Šikuta,
Päivi Hirvelä, *gjyqtar*,

dhe Lawrence Early, *Sekretar i Seksionit*,

Pas shqyrtimit të çështjes me dyer të mbyllura më 13 nëntor 2008,

Merr vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në të njëjtën datë:

PROCEDURA

1. Çështja ka filluar me kërkesën (nr. 2872/02) kundër Republikës së Finlandës, të parashtruar në Gjykatë në përputhje me Nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (më poshtë “Konventa”) nga një nënshtetas finlandez (“kërkuesi”) më 1 janar 2002. Kryetari i Dhomës e pranoi kërkesën e kërkuesit për mos bërje me dije të emrit të tij (rregulli 47 § 3 i Rregullores së Gjykatës).

2. Kërkuesi u përfaqësua nga Z. P. Huttunen, avokat që e ushtron aktivitetin e tij në Helsinki. Qeveria finlandeze (“Qeveria”) u përfaqësua nga Agjenti i saj, Z. Arto Kosonen nga Ministria e Punëve të Jashtme.

3. Kërkuesi pretendonte posaçërisht që shteti e kishte shkeluar detyrimin e tij pozitiv për të mbrojtur të drejtën e tij për jetë familjare, sipas nenit 8 të Konventës.

4. Me anë të një vendimi, datë 27 qershor 2006, Gjykata e deklaroi kërkesën të pranueshme.

5. Si kërkuesi dhe qeveria depozituan secili komente të tjera me shkrim (rregulli 59 § 1). Dhoma vendosi, pas konsultimeve me palët, se nuk nevojiteshin seanca për themelin e çështjes (rregulli 59 § 3 *in fine*), kështu që palët iu përgjigjën me shkrim komenteve të njëra-tjetrës. Për më tepër, u morën komente edhe nga një palë e tretë, përkatësisht nga Fondacioni i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, të cilit i ishte dhënë leje nga Presidenti për të ndërhyrë në procedurën me shkrim (neni 36 § 2 dhe Rregulli 44 § 2).

FAKTET E ÇËSHTJES

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Kërkuesi ka lindur në vitin 1986.

7. Më 15 mars 1999 një person ose disa persona të panjohur vendosën një njoftim në një faqe interneti për takime dhe njohje në emrin e kërkuesit, i cili në atë kohë ishte vetëm 12 vjeç, pa dijeninë e këtij të fundit. Njoftimi përmendte moshën dhe vitin e lindjes së kërkuesit, jepte një përshkrim të detajuar të karakteristikave fizike të tij, një *link* për tek faqja e internetit që ai kishte në atë kohë, ku jepej fotografia e tij, si dhe numri i tij i telefonit, i cili ishte i saktë me përjashtim vetëm të një shifre. Në njoftim thuhej se ai ishte i interesuar për një lidhje intime me një djalë të moshës së tij, ose më të madh “për t’i treguar atij rrugën”.

8. Kërkuesi u vu në dijeni të njoftimit në Internet në kohën kur mori një e-mail nga një burrë, i cili ofrohej ta takonte dhe “më pas të shihte se për çfarë kishte nevojë ai”.

9. Babai i kërkuesit i kërkoi policisë të identifikonte personin që kishte bërë njoftimin në internet në mënyrë që të ngrinte padi kundër tij. Por, ofruesi i shërbimit të internetit refuzoi ta jepte identitetin e mbajtësit të të ashtuquajturës adresë dinamike e IP-së, duke e konsideruar veten të detyruar të respektonte konfidencialitetin e telekomunikimeve, siç përcaktohej në ligj.

10. Policia i kërkoi më pas Gjykatës së Shkallës së Parë të Helsinkit (*käräjaoikeus, tingsrätten*) t’i kërkonte ofruesit të shërbimit t’ia jepte informacionin e sipërpërmendur, në përputhje me seksionin 28 të Aktit për Hetimet Penale (*esitutkintalaki, förundersökningslagen*; Akti nr. 449/1987, siç është ndryshuar me Aktin nr. 692/1997).

11. Në një vendim të marrë më 19 janar 2001, Gjykata e Shkallës së Parë e rrëzoi kërkesën, me arsyetimin se kishte një dispozitë të qartë ligjore që e autorizonte atë për të urdhëruar ofruesin e shërbimit të bënte me dije të dhëna identifikimi për telekomunikacionet në shkelje të sekretit profesional. Gjykata u shpreh se në përputhje me Kreun 5a, seksioni 3, Akti për Masat Detyruese (*pakkokeinolaki, tvångsmedelslagen*; Akti nr. 450/1987) dhe me seksionin 18 për Aktin e Mbrojtjes së Privacisë dhe Sigurisë së të Dhënave të Telekomunikacioneve (*laki yksityisyydensuojasta televiestinnässä ja teletoiminnan tietoturvasta, lag om integritetsskydd vid telekommunikation och dataskydd inom televerksamhet*; Akti nr. 565/1999) policia ka të drejtë të marrë të dhëna për identifikimin e telekomunikacioneve për çështjet e lidhura me vepra të caktuara, pavarësisht nga detyrimi i ruajtjes së sekretit. Megjithatë, keqpërfaqësimi keqdashës nuk përbën një vepër të tillë.

12. Më 14 mars 2001 Gjykata e Apelit (*hovioikeus, hovrätten*) e rikonfirmoi vendimin dhe më 31 gusht 2001 Gjykata e Lartë (*korkein oikeus, högsta domstolen*) refuzoi lejen për apel.

13. Personi që iu përgjigj njoftimit për takim/njohje dhe që e kontaktoi kërkuesin u identifikua nëpërmjet adresës së tij të e-mailit.

14. Drejtori menaxhues i kompanisë që ofronte shërbimin e Internetit nuk mund të akuzohej, për shkak se në vendimin e tij, datë 2 prill 2001, prokurori konstatoi se vepra e pretenduar i kishte kaluar afatet. Vepra e pretenduar kishte të bënte me shkelje të Aktit të të Dhënave Personale (*henkilötietolaki, personuppgiftslagen*; Akti nr. 523/99, i cili hyri në fuqi më 1 qershor 1999). Më specifikisht, ofruesi i shërbimit kishte botuar një njoftim shpifës në faqen e tij të shërbimit pa e verifikuar identitetin e dërguesit.

II. E DREJTA E BRENDESHME DHE PRAKTIKA GJYQËSORE

15. Deri më 1 mars 2000 në Finlandë ka qenë në fuqi Akti i Kushtetutës së Finlandës (*Suomen hallitusmuoto, Regeringsform för Finland*; Akti nr. 94/1919, i ndryshuar nëpërmjet Aktit nr. 969/1995). Seksioni 8 korrespondon me nenin 10 të Kushtetutës aktuale finlandeze (*Suomen perustuslaki, Finlands grundlag*; Akti nr. 731/1999) garantimi i së drejtës për jetë private.

16. Në kohën materiale, Kreu 27, neni 3, i Kodit Penal (*rikoslaki, strafflagen*; Akti nr. 908/1974) parashikonte:

“Çdo person, i cili në një mënyrë të ndryshme nga çfarë u përmend më sipër, kryen aktin e keqpërfaqësimit keqdashës kundrejt një personi tjetër me anë të një deklaratë përjashtimore, kërcënimi ose nëpërmjet ndonjë akti tjetër poshtërues dënohet për keqpërfaqësim keqdashës me gjobë, ose burg prej jo më shumë se tre muajsh.

Në rast se keqpërfaqësimi keqdashës bëhet në publik ose në median e shkruar, me shkrim ose me anë të një prezantimi grafik të shpërndarë nga pala fajtores, ose të shkaktuar nga pala fajtores, personi përgjegjës dënohet me gjobë, ose me burgim prej jo më shumë se katër muajsh.”

17. Në kohën materiale, Kreu 5a, seksioni 3, i Aktit për Masat Detyruese parashikonte:

“Parakushtet e monitorimit të telekomunikimeve

Kur ka arsye për të dyshuar për një person për

- 1) një vepër të dënueshme me jo më pak se katër muaj heqje lirie,
- 2) një vepër kundër një sistemi kompjuterik që përdor një mjet të brendshëm/terminal, një vepër penale të lidhur me lëndët narkotike, ose
- 3) një përpjekje të dënueshme për kryerjen e një veprë që përmendet më lart në këtë seksion,

Organi që kryen hetimin penal mund të autorizohet të monitorojë lidhjen e telekomunikacioneve që zotërohet nga i dyshuari, ose që prezumohet të përdoret prej këtij të fundit, ose të çaktivizojë në mënyrë të përkohshme këtë lidhje, në rast se

informacioni i marrë nga monitorimi ose çaktivizimi i lidhjes prezumohet se është shumë i rëndësishëm për hetimin e veprës ...”

18. Seksioni 18, nënseksioni 1(1) i Aktit të Mbrojtjes së Privacisë dhe Sigurisë së të Dhënave të Telekomunikacioneve, i cili ka hyrë në fuqi më 1 korrik 1999 dhe që u shfuqizua më 1 shtator 2004, parashikonte se:

“pa cenuar detyrimin e sekretit të parashikuar në Seksionin 7, policia ka të drejtën e marrjes së:

(1) të dhënave të identifikimit për transmetimet në një lidhje të veçantë transkriptimi, me pëlqimin e palës së dëmtuar dhe të pronarit të lidhjes së abonentit, të nevojshme për qëllimin e veprës së cilës i referohet Kreu 16, neni 9a, Kreu 17, neni 13(2) ose Kreu 24, neni 3a i Kodit Penal (Akti nr. 39/1889) ...”

19. Seksioni 48 i Aktit për të Dhënat Personale parashikon që ofruesi i shërbimit ka përgjegjësi penale për identifikimin e identitetit të dërguesit para botimit të një njoftimi shpifës në faqen e tij të internetit. Seksioni 47 parashikon që ofruesi i shërbimit është po ashtu përgjegjës për dëmet.

20. Në kohën materiale, përpunimi dhe botimi i informacionit të ndjeshëm lidhur me sjelljen seksuale në një server interneti pa pëlqimin e subjektit parashikohej si vepër penale për mbrojtjen e të dhënave në seksionin 43 të Aktit të Dosjeve Personale (Akti nr. 630/1995) dhe Kreun 38, neni 9 (Akti nr. 578/1995) të Kodit Penal, dhe si shkelje e mbrojtjes së të dhënave në seksionin 44 të Aktit të Dosjeve Personale. Për më tepër, ky akt mund të shkaktonte përgjegjësi për dëmet e parashikuara në Seksionin 42 (Akti nr. 471/1987) të Aktit të përmendur më lart.

21. Seksioni 17 i Aktit të Ushtrimit të Lirisë së Shprehjes në Mas Media (*laki sanavapauden käyttämisestä joukkoviestinnässä, lagen om yttrandefrihet i masskommunikation*: Akti nr. 460/2003), i cili hyri në fuqi më 1 janar 2004, parashikon:

“Dhënia e informacionit identifikues për një mesazh në rrjet

Me kërkesë të një personi që ka të drejtë të arrestojë, të një prokurori publik ose një pale të dëmtuar, gjykata mund ta urdhërojë mbajtësin e transmetuesit, serverit ose të një mjeti tjetër të ngjashëm të japë informacionin që kërkohet për identifikimin e dërguesit të një mesazhi në rrjet tek kërkuesi, me kusht që ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që përmbajtjet e mesazhit janë të tilla që bërja e tij e ditur për publikun përbën vepër penale. Gjithsesi, dhënia e informacionit identifikues për palën e dëmtuar mund të urdhërohet vetëm në rast se kjo palë ka të drejtë të bëjë ndjekje private për veprën. Kërkesa i depozitohet Gjykatës së Rrethit të vendbanimit të mbajtësit të mjetit, ose Gjykatës së Rrethit të Helsinkit, brenda tre muajash nga botimi i mesazhit në fjalë. Gjykata mund ta përforcojë urdhrin nëpërmjet imponimit të kërcënimit për gjobë.

III. MATERIALE NDËRKOMBËTARE TË RËNDËSISHME

A. Këshilli i Evropës

22. Zhvillimi i shpejtë i teknologjive të informacionit në dekadat e fundit ka çuar në lindjen e llojeve të reja të krimit dhe ka bërë po ashtu të mundur kryerjen e krimeve tradicionale me anë të teknologjive të reja. Këshilli i Evropës e ka pranuar nevojën për t'iu përgjigjur në kohën e duhur dhe shpejt kësaj sfide të re që në vitin 1989, kohë kur Komiteti i Ministrave miratoi Rekomandimin Nr. R (89) 9 për krimet e lidhura me kompjuterin. I vendosur për të siguruar se autoritetet hetuese kanë kompetencat e nevojshme të posaçme për hetimin e krimeve të lidhura me kompjuterin, në vitin 1995 Komiteti i Ministrave miratoi Rekomandimin Nr. R (95) 13 lidhur me problemet e të drejtës procedurale penale me teknologjinë e informacionit. Në pikën 12 të parimeve që i bashkëlidhen shtojcës, Komiteti rekomandon:

“vendosjen e detyrimeve specifike për ofruesit e shërbimeve që ofrojnë shërbime telekomunikacioni për publikun, ose nëpërmjet rrjeteve publike ose private, për të ofruar informacion për të identifikuar përdoruesin, kur kjo gjë urdhërohet nga organi përgjegjës i hetimit.”

23. Parimet e tjera që lidhen me detyrimin për bashkëpunim me organet hetuese deklarojnë se:

“9. Në varësi të privilegjeve ose mbrojtjes ligjore, pjesa më e madhe e sistemeve ligjore i lejojnë organet hetuese t'i urdhërojnë njerëzit që t'i dorëzojnë objekte që kanë në kontrollin e tyre organeve hetuese, kur ato kërkohet të shërbejnë si prova. Paralelisht duhet të krijohen dispozitat për kompetencën për t'i urdhëruar njerëzit të japin çdo të dhënë që ata kanë nën kontroll në sistemin kompjuterik, në formën e kërkuar prej organit hetues.

10. Në varësi të privilegjeve ose mbrojtjes ligjore, organet hetimore duhet të kenë të drejtë t'i urdhërojnë njerëzit që kanë të dhëna në një sistem kompjuterik të kontrolluar prej tyre të japin të gjithë informacionin e nevojshëm për të lejuar hyrjen në një sistem kompjuterik dhe në të dhënat e tij. E drejta e procedurës penale duhet të sigurojë dhënie të një urdhri të ngjashëm për personat që kanë njohuri për funksionimin e një sistemi kompjuterik, ose për masat që aplikohen për të siguruar të dhënat e tyre.”

24. Në vitin 1996, Komiteti Evropian për Problemet e Krimit krijoi një komitet ekspertësh për t'u marrë me krimin kibernetik. U ndje që, megjithëse dy rekomandimet e mëparshme nuk është se kishin kaluar pa u vënë re, vetëm një instrument ligjor i detyrueshëm mund të siguronte efikasitetin e nevojshëm në luftën kundër veprave në hapësirën kibernetike. Konventa për Krimin Kibernetik u hap për nënshkrim më 23 nëntor 2001 dhe hyri në fuqi më 1 korrik 2004. Konventa është traktati i parë dhe i fundit për krimet e kryera nëpërmjet Internetit dhe është e hapur për të gjitha shtetet anëtare. Konventa u kërkon shteteve palë të përcaktojnë si vepër penale aktet e mëposhtme: aksesin e paligjshëm në një sistem

kompjuterik, gjurmimin e paligjshëm të të dhënave kompjuterike, ndërhyrjet në të dhëna ose në një sistemin kompjuterik, keqpërdorimin e aparaturave, faslifikimet dhe mashtrimet e lidhura me kompjuterin, pornografinë e fëmijëve, shkeljen e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me to. Protokolli shtesë i miratuar në vitin 2003 kërkon më tej kriminalizimin e fjalimeve të urrejtjes, ksenofobisë dhe racizmit. Objekti i dispozitave procedurale të Konventës shkon përtej veprave të përcaktuara në Konventë, në kuptimin që ai zbatohet për çdo vepër të kryer me anë të një sistemi kompjuterik:

“Neni 14 – Objekti i dispozitave procedurale

1. Secila Palë miraton masa legislative ose masa të tjera, sipas nevojës, për të përcaktuar kompetencat dhe procedurat e parashikuara në këtë seksion për qëllimin e hetimeve ose të proceseve specifike penale.

2. ... secila Palë zbaton kompetencat dhe procedurat që përmenden në paragrafin 1 të këtij neni për:

a) veprat penale të përcaktuara në përputhje me nenin 2 deri në nenin 11 të kësaj Konvente;

b) veprat e tjera penale të kryera me anë të një sistemi kompjuterik; dhe

c) mbledhjen e provave në mënyrë elektronike për një vepër penale.

3. ...”

25. Kompetencat procedurale përfshijnë: ruajtjen e përsheptuar të të dhënave të ruajtura, ruajtjen e përsheptuar dhe bërjen e pjeshme publike të të dhënave të trafikut, urdhrin e prodhimit, kontrollin dhe sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, mbledhjen në kohë reale të të dhënave të trafikut dhe gjurmimin e të dhënave të përmbajtjes. Rëndësi të posaçme ka kompetenca për të urdhëruar një ofrues shërbimi të japë informacion abonenti lidhur me shërbimet e tij; në fakt, raportet shpjeguese e përshkruajnë vështirësinë në identifikimin e autorit si një ndër sfidat kryesore në luftën kundër krimit në mjediset në rrjet.

“Neni 18 – Urdhri i Prodhimit

1. Secila Palë miraton masat legislative dhe masat e tjera të nevojshme për të fuqizuar organet përgjegjëse për të urdhëruar:

a) një person në territorin e saj të japë të dhëna specifike kompjuterike që mbahen ose kontrollohen prej tij, të cilat janë të ruajtura në një sistem kompjuterik ose në një mjet ruajtje të dhënash; dhe

b) një ofrues shërbimi që i ofron shërbimet e tij në territorin e kësaj Pale të japë informacion abonenti lidhur me këto shërbime që janë në zotërimin ose në kontrollin e këtij ofruesi shërbimi.

2. Kompetencat dhe procedurat që përmenden në këtë nen janë objekt i nenit 14 dhe 15.

3. Në kuptimin e këtij neni, termi “informacion abonenti” nënkupton çdo informacion që ekziston në formën e të dhënave kompjuterike, ose në çdo formë tjetër që mbahet nga një ofrues shërbimi, lidhur me abonentët e shërbimeve të tij, të ndryshme nga të dhënat e trafikut ose të përmbajtjes, dhe nëpërmjet të cilit mund të përcaktohet:

a) lloji i shërbimit të komunikimit të përdorur, dispozitat teknike të tij dhe periudha e shërbimit;

b) identiteti i abonentit, adresa postare ose gjeografike, numri i telefonit ose numra të tjerë aksesit, informacioni i faturimit dhe i pagesave, i disponueshëm mbi bazën e marrëveshjeve ose organizimit të shërbimit;

c) çdo informacion tjetër në faqen e instalimit të pajisjes së komunikimit, e cila është e disponueshme mbi bazën e marrëveshjes ose organizimit të shërbimit.”

26. Raporti shpjegues vëren se gjatë një hetimi penal, informacioni për abonentin mund të nevojitet kryesisht në dy situata. Së pari, për të identifikuar se cilat shërbime dhe masa teknike të lidhura janë përdorur më parë ose po përdoren tani nga abonenti, të tilla si lloji i shërbimit telefonik, lloji i shërbimeve të tjera të lidhura (të tilla si transferimi i thirrjeve, mesazhet zanore), numri i telefonit ose ndonjë adresë tjetër teknike (p.sh adresa e e-mail-it). Së dyti, kur njihet adresa teknike, duhet informacioni i abonentit për të ndihmuar në përcaktimin e identitetit të personit në fjalë. Urdhi i prodhimit përbën një masë më pak ndërhyrëse dhe më pak të ngarkuar që organet e zbatimit të ligjit mund të zbatojnë në vend të masave të tilla si gjurmimi i të dhënave të përmbajtjes dhe të mbledhjes në kohë reale të të dhënave të trafikut, të cilat duhet ose mund të kufizohen vetëm tek veprat e rënda (neni 20 dhe 21).

27. Në një konferencë globale, me titullin “Bashkëpunimi kundër Krimit Kibernetik”, e organizuar në Strasburg nga data 1-2 prill 2008, u miratuan “Udhëzimet për bashkëpunim ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit dhe ofruesve të shërbimit të internetit kundër krimit kibernetik.” Qëllimi i tyre është t’u vijë në ndihmë organeve të zbatimit të ligjit dhe ofruesve të shërbimit të internetit të strukturojnë ndërveprimin e tyre në lidhje me çështje të krimit kibernetik. Për të rritur sigurinë e krimit kibernetik dhe për të minimizuar përdorimin e shërbimeve për qëllime të paligjshme, u konsiderua e domosdoshme që të dyja palët të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në mënyrë eficiente. Udhëzimet japin masa praktike që duhet të merren prasysh nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe nga ofruesit e shërbimit, duke i inkurajuar ato të shkëmbejnë informacion për të forcuar kapacitetin e tyre për të identifikuar dhe për të luftuar llojet e reja të krimit kibernetik. Në veçanti ofruesit e shërbimeve inkurajohen të bashkëpunojnë me agjencitë e zbatimit të ligjit për të ndihmuar në minimizimin e masës së përdorimit të shërbimeve për aktivitetin penal të përshkruar në ligj.

B. Kombet e Bashkuara

28. Nga disa rezoluta të miratuara në fushën e krimit kibernetik, më të rëndësishme për qëllimet e çështjes në fjalë janë Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 55/63, datë 4 dhjetor 2000, dhe Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 56/121, datë 19 dhjetor 2001 për “Luftën kundër Keqpërdorimit Kriminal të Teknologjive të Informacionit”. Ndërmjet masave për të luftuar këto keqpërdorime, në Rezolutën 55/63 u rekomandua që:

“(f) Sistemet ligjore duhet të lejojnë ruajtjen dhe aksesin e shpejtë në të dhënat elektronike që lidhen me hetime të caktuara penale;”

29. Rezoluta tjetër nënvizoi vlerën e masave të ndryshme dhe i ftoi sërish shtetet anëtare që t’i merrnin parasysh këto masa.

C. Bashkimi Evropian

30. Më 15 mars 2006, Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian miratuan Direktivën 2006/24/EC për ruajtjen e të dhënave të gjeneruara ose të përpunuara lidhur me ofrimin e shërbimeve publike të disponueshme të komunikimeve elektronike, ose të rrjeteve të komunikimeve publike, e cila ndryshoi Direktivën 2002/58/EC për ruajtjen e të dhënave. Qëllimi i Direktivës është të harmonizojë dispozitat e shteteve anëtare lidhur me detyrimet e ofruesve të komunikimeve për ruajtjen e disa të dhënave të caktuara, për t’u siguruar se të dhënat janë të disponueshme për qëllime të hetimit, zbulimit dhe ndjekjes së krimeve të rënda, siç përcaktohet nga çdo shtet anëtar në të drejtën e tij të brendshme. Ajo zbatohet si për të dhënat e trafikut dhe për ato të vendndodhjes, si për subjektet ligjore dhe për personat fizikë, edhe për të dhënat e lidhura të nevojshme për të identifikuar abonentin ose përdoruesin e regjistruar. Direktiva nuk zbatohet për përmbajtjen e komunikimeve elektronike. Direktiva u kërkon shteteve anëtare të sigurojnë se kategori të caktuara të dhënash ruhen për një periudhë nga gjashtë muaj deri në dy vjet. Neni 5 specifikon të dhënat që duhet të ruhen:

“1. Shtetet Anëtarë sigurojnë ruajtjen e kategorive të mëposhtme të të dhënave bazuar në këtë Direktivë:

(a) të dhënat e nevojshme për të gjurmuar dhe për të identifikuar burimin e informacionit:

...

(2) lidhur me aksesin në Internet, e-mail-in në internet dhe telefoninë nëpërmjet internetit:

...;

(iii) emrin dhe adresën e abonentit ose të përdoruesit të regjistruar, të cilit i është dhënë një adresë Protokolli Interneti (IP), Kartë Identiteti (ID) përdoruesi ose një numër telefoni në kohën e komunikimit;”

31. Shtetet Anëtare kishin kohë të zbatonin Direktivën deri më 15 shtator 2007. Gjithsesi, 16 shtete, duke përfshirë dhe Finlandë, përdorën të drejtën e shtyrjes së aplikimit të tyre për akses në Internet, telefoninë nëpërmjet Internetit dhe e-mail-in nëpërmjet internetit deri më 15 mars 2009.

IV. E DREJTA KRAHASUESE

32. Një rishikim krahasimor i legjislacionit kombëtar të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës tregon se në pjesën më të madhe të shteteve ekziston detyrimi specifik për ofruesit e shërbimit të internetit për të dhënë të dhëna kompjuterike, duke përfshirë informacion për abonentin, në përgjigje të një kërkesë nga organet hetuese ose gjyqësore, pavarësisht nga natyra e krimit. Disa shtete kanë vetëm dispozita të përgjithshme për prodhimin e dokumenteve dhe të dhënave të tjera, të cilat në praktikë duhet të zgjerohen për të mbuluar dhe detyrimin për të dhënë të dhëna specifike kompjuterike dhe për abonentin. Disa vende nuk e kanë zbatuar ende dispozitën e nenit 18 të Konventës së Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik.

V. PARASHTRIMET NGA PALËT E TRETA

33. Fondacioni i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut parashtroi se çështja në fjalë shtron problemin e balancimit të mbrojtjes së privacisë, nderit dhe reputacionit, nga njëra anë, dhe ushtrimit të lirisë së shprehjes, nga ana tjetër. Ai u shpreh se kjo çështje i jep mundësi Gjykatës të përcaktojë detyrimet pozitive të shtetit në këtë sferë, për të promovuar standardet e përbashkëta për përdorimin e Internetit në të gjitha shtetet anëtare.

34. Fondacioni theksoi se Interneti është metodë shumë speciale komunikimi dhe se njëri ndër parimet bazë të përdorimit të tij është anonimiteti. Niveli i lartë i anonimitetit e inkurajon lirinë e shprehjes dhe shprehjen e ideve të ndryshme. Në anën tjetër, Interneti është instrument i rëndësishëm për shpifjen ose për fyerjen e njerëzve, ose për të shkelur të drejtën e tyre për privaci. Për shkak të anonimitetit të Internetit, viktimat e një shkeljeje është në pozicion vulnerabël. Në kundërshtim me median tradicionale, viktimat nuk mund të identifikojë lehtë personin që ka shpifur për shkak se është e mundur që ai/ajo të fshihesh pas një nofke, madje edhe të përdorësh identitet të rremë.

LIGJI

I. PRETENDIMET PËR SHKELJE TË NENIT 8 DHE 13 TË KONVENTËS

35. Kërkuesi u ankua mbi bazën e nenit 8 të Konventës për ndërhyrje në jetën e tij private dhe për mungesën e një mjeti efektiv ligjor për të dhënë identitetin e personit që kishte vendosur tekstin shpifës në internet në emrin e tij, në kundërshtim me nenin 13 të Konventës.

Neni 8 parashikon se:

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Neni 13 parashikon si më poshtë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

A. Parashtrimet e palëve

36. Kërkuesi u shpreh se legjislacioni finlandez në atë kohë e mbronte kriminelin, ndërkohë që viktima nuk kishte mënyra për t’u shpërblyer ose për t’u mbrojtur kundër shkeljes së privacisë. Sipas Kodit Penal, akti në fjalë ishte i dënueshëm, por Qeveria kishte neglizhuar të merrte masat për sigurimin e përputhshmërisë së Aktit për Mbrojtjen e Privacisë dhe për Sigurinë e të Dhënave në Telekomunikacione me Aktin e Masave Shtrënguese. Ai pretendoi se mundësia e rrallë e kërimit të dëmeve civile, në veçanti nga një palë e tretë, nuk ishte e mjaftueshme për mbrojtjen e të drejtave të tij. Ai theksoi se nuk i kishte mjetet për identifikimin e personave që e kishin botuar reklamën në Internet. Ndërkohë që kompensimi në disa raste mund të jetë mjet efektiv ligjor, kjo varej nëse ai paguhej nga personi që i shkelte të drejtat e viktimës, gjë që nuk ishte kështu në aplikimin e tij. Sipas Qeverisë, ka hyrë në fuqi një ligj i ri, i cili, po të kishte ekzistuar në kohën e ngjarjeve do ta kishte bërë këtë kërkesë të panevojshme. Sipas pikëpamjes së kërkuesit, Qeveria nuk ka dhënë asnjë justifikim për dështimin në ofrimin e mbrojtjes për të në kohën materiale. Si rezultat, ai ishte i mendimit se ishte shkelur neni 8 dhe neni 13 i Konventës.

37. Qeveria theksoi se në çështjen në fjalë, ndërhyrja në jetën private të kërkuesit është shkaktuar nga një individ tjetër. Akti në fjalë konsiderohet nga e drejta e brendshme si akt i keqpërfaqësimit keqdashës dhe do të ishte

dënuar si i tillë, po të mos të kishte qenë për efektin pengues. Kishte nisur një hetim për të identifikuar personin që e kishte botuar në internet njoftimin, por kjo përpjekje rezultoi e pasuksesshme për shkak të legjislacionit në fuqi në atë kohë, i cili synonte të ruante lirinë e shprehjes dhe të drejtën për shprehje anonime. Legjislacioni e mbronte botuesin e një mesazhi anonim në Internet kaq shumë sa që mbrojtja mbulonte dhe mesazhe që mbase ndërhyjnë me privacinë e një personi tjetër. Ky efekt anësor i mbrojtjes shkaktohej nga fakti që koncepti i mesazhit që ndërhynte në mbrojtjen e privacisë nuk ishte e prerë dhe, si rezultat, nuk kishte qenë e mundur të përjashtoheshin shprehimisht këto mesazhe nga mbrojtja e parashikuar me ligj. Gjithsesi, pavarësisht nga kjo, kishte pista të tjera dëmshpërblimi të disponueshme, të tilla si Akti i të Dhënave Personale, i cili parashikonte mbrojtje kundër keqpërfaqësimit keqdashës, pasi operatori i serverit, mbi bazën e dispozitave të këtij Akti lidhur me përgjegjësinë penale dhe përgjegjësinë për dëme, ishte i detyruar të siguronte që të dhënat e ndjeshme të regjistruara prej tij të përpunoheshin me pëlqimin e subjektit të të dhënave. Për më tepër, megjithëse veprës për të dhënat personale i kishin kaluar afatet, kërkuesi kishte mundësinë të kërkonte dëmshpërblim nga botuesi i njoftimit. Duke e krahasuar me çështjen *X dhe Y k. Holandës* (vendim, datë 26 mars 1985, Seritë A nr. 91), në çështjen në fjalë përgjegjësia për dëme në kuadrin e një vepre më pak të rëndë jepte efekt të mjaftueshëm pengues. Plus, kërkuesi kishte dhe mekanizma të tjerë të disponueshmë, të tillë si hetimet policore para gjykimit, prokurorinë, proceset gjyqësore dhe dëmet.

38. Qeveria parashtroi se ishte e rëndësishme të shihej situata e legjislacionit në kohën materiale në kuadrin e saj social, kur po fillonte një rritje e shpejtë në përdorimin e internetit. Legjislacioni aktual, Akti i Ushtrimit të Lirisë së Shprehjes në Mas Media (seksionet 2 dhe 17), i cili hyri në fuqi më 1 janar 2004, i jep policisë kompetenca më të mëdha për të thyer mbrojtjen e botuesit të një mesazhi anonim në internet për qëllim të hetimit të krimit. Ligji i ri reflekton reagimin e ligjvënësit ndaj zhvillimeve sociale, ku përdorimi më i madh (dhe njëkohësisht dhe abuzimi) i Internetit kërkonin ripërkufizim të kufijve të mbrojtjes. Në këtë mënyrë, për shkak të situatës së ndryshuar në shoqëri, ligji pasues e ka forcuar mbrojtjen e jetës personale në lidhje me lirinë e shprehjes dhe veçanërisht mbrojtjen e botuesve të mesazheve anonime në Internet.

39. Gjithsesi, ajo çfarë është më e rëndësishmja në çështjen në fjalë ishte që edhe legjislacioni në fuqi në kohën materiale i ofronte kërkuesit mjete veprimi kundër shpërndarjes së mesazhit që e cenonte atë, pasi operatori i serverit të internetit ku ishte botuar mesazhi ishte i detyruar me ligj të verifikonte që personi në fjalë të kishte dhënë pëlqimin për përpunimin e informacionit sensitiv në lidhje me të në serverin e operatorit. Ky detyrim mbështetet nga përgjegjësia penale dhe përgjegjësia për dëmet. Pra,

legjislacioni i jepte kërkuessit mbrojtje të mjaftueshme të privacisë dhe mjete efektive ligjore.

B. Vlerësimi i Gjykatës

40. Gjykata vëren që në fillim që kërkuessi, minoren në moshën 12 vjeçare në atë kohë, ishte objekt i një njoftimi me natyrë seksuale në një faqe interneti për takime. Identiteti i personit që e kishte botuar njoftimin në atë kohë nuk mund të merrej nga ofruesi i Internetit për shkak të legjislacionit në fuqi në atë kohë.

41. Nuk ka diskutim lidhur me zbatueshmërinë e nenit 8: faktet e kërkesës lidhen me një çështje “të jetës private”, një koncept i cili bulon integritetin fizik dhe moral të personit (*shih X dhe Y k. Holandës*, cituar më lart, § 22). Megjithëse në termat e së drejtës së brendshme kjo çështje konsiderohet si keqpërfaqësim keqdashës, Gjykata preferon t’i theksojë këto aspekte të veçanta të nocionit të jetës private, duke pasur parasysh kërcënimet potenciale të mirëqenies fizike dhe mendore të kërkuessit, të shkaktuara nga situata në diskutim, dhe vulnerabilitetin për shkak të moshës së tij të re.

42. Gjykata thekson se, megjithëse objekti i nenit 8 është kryesisht mbrojtja e individit kundër ndërhyrjes arbitrare nga organet publike, ai jo thjesht e detyron shtetin të abstenojë nga kjo ndërhyrje, por përveç kësaj sipërmarrje kryesisht negative, shteti mund të ketë edhe detyrime pozitive që janë pjesë e respektimit efektiv për jetën private dhe familjare (*shih Airey k. Irlandës*, vendimi, datë 9 tetor 1979, Seritë A nr. 32, § 32).

43. Këto detyrime mund të përfshijnë miratimin e masave të hartuara për të siguruar respektimin e jetës private edhe në sferën e marrëdhënieve të individëve ndërmjet tyre. Ka mënyra të ndryshme të sigurimit të respektimit të jetës private dhe natyra e detyrimit të shtetit do të varet nga aspekti i veçantë në diskutim i jetës private. Ndërkohë që përzgjedhja e mjeteve për të siguruar përputhshmërinë me nenin 8 në sferën e mbrojtjes kundër akteve të individëve, në parim bie brenda pragut të vlerësimit të shtetit, pengimi efektiv nga aktet serioze, të cilat rrezikojnë vlerat themelore dhe aspektet kryesore të jetës private, kërkon dispozita efektive të së drejtës penale (*shih X dhe Y k. Holandës*, §§ 23-24 dhe 27; *gusht k. Mbretërisë së Bashkuar* (ven.), nr. 36505/02, 21 janar 2003, dhe *M.C. k. Bullgari*, nr. 39272/98, § 150, GJEDNJ 2003-XII).

44. Kufijtë e pragut të vlerësimit të organeve kombëtare parashikohen nga Konventa. Në interpretimin e tyre, përderisa Konventa është së pari dhe kryesisht sistem i mbrojtjes të së drejtave të njeriut, Gjykata duhet të ketë parasysh kushtet në ndryshim brenda Shteteve Kontraktuese dhe duhet t’i përgjigjet, për shembull, çdo konvergjence që shfaqet lidhur me standardet që duhet të arrihen (*shih Christine Goodwin k. Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 28957/95, § 74, GJEDNJ 2002-VI).

45. Gjykata shprehet që, ndërsa kjo çështje mund të mos marrë seriozitetin e çështjes *X dhe Y k. Holandës*, në të cilën shkelja e nenit 8 rezultoi nga mungesa e një sanksioni efektiv penal për përdhunimin e një vajze me aftësi të kufizuar, ajo nuk mund të trajtohet si me pak rëndësi. Akti ishte kriminal, përfshinte një minoren dhe e bënte atë objekt për qasje me pedofilë (shih, po ashtu, paragrafin 41 më lart për këtë pikë).

46. Qeveria e pranoi se në atë kohë operatori i serverit nuk mund të urdhërohej të jepte informacion që identifikonte autorin e krimit. Ajo pretendoi se mbrojtja ofrohej nga vetë ekzistenca e veprës penale të keqpërfaqësimit keqdashës dhe nga mundësia e ngritjes së akuzave penale ose të një padie për dëme kundër operatorit të serverit. Në lidhje me të parën, Gjykata vëren se prania e një veprë kufizon efektet penguese në rast se nuk ka mjete për të identifikuar autorin e veprës dhe për ta vënë atë para drejtësisë. Këtu Gjykata vëren se nuk përjashtohet mundësia që detyrimet pozitive të shtetit sipas nenit 8 për garantimin e integritetit fizik ose moral të individit mund të shtrihen në çështje lidhur me efektivitetin e një hetimi penal dhe në rast se nuk është në diskutim përgjegjësia penale e agjentëve të shtetit (shih *Osman k. Britërisë së Bashkuar*, vendim, datë 28 tetor 1998, *Rapporte të Vendimeve Gjyqësore* 1998-VIII, § 128). Për Gjykatën shtetet kanë detyrimin pozitiv të mbartur nga neni 8 i Konventës për të kriminalizuar vepra kundër personit, duke përfshirë veprat në tentativë, dhe për të theksuar efektin pengues të kriminalizimit duke zbatuar dispozita të së drejtës penale në praktikë nëpërmjet hetimit dhe ndjekjes efektive (shih, *mutatis mutandis*, *M.C. k. Bullgarisë*, cituar më lart, § 153). Kur kërcënohet mirëqenia fizike dhe morale e një fëmije, ky ndalim kërkon rëndësi edhe më të madhe. Gjykata kujton në këtë drejtim se abuzimi seksual është pa dyshim një lloj shumë i keq keqbërje, me efekte të mëdha tek viktimat. Fëmijët dhe individë të tjerë vulnerabël kanë të drejtë të mbrohen nga shteti, në formën e pengimit efektiv, nga lloje të tilla të rënda ndërhyrjeje në aspektet themelore të jetës së tyre private (shih *Stubbings dhe të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, 22 tetor 1996, § 64, *Rapëortet* 1996-IV).

47. Lidhur me argumentin e Qeverisë që kërkuesi kishte mundësi të merrte dëmshpërblim nga një palë e tretë, përkatësisht nga ofruesi i shërbimit, Gjykata është e mendimit se kjo gjë nuk është e mjaftueshme në rrethanat e kësaj çështje. Është e qartë që si interesi publik dhe mbrojtja e interesave të viktimave të krimeve kundër miqëqënies së tyre fizike ose psikologjike kërkojnë praninë e një mjeti efektiv ligjor që lejon identifikimin e autorit të veprës dhe përgjegjësisë së tij para drejtësisë, që në rastin në fjalë është personi që e ka vënë njoftimin me emrin e kërkuesit, ndërkohë që viktimat duhet të marrë dëmshpërblim financiar prej tij.

48. Gjykata e pranon se në kuadrin e vështirësive të përfshira në policimin e shoqërive moderne, një detyrim pozitiv duhet të interpretohet në një mënyrë që nuk imponon një barrë të pamundur ose jo përpjesëtimore për organet, ose, siç është rasti, për ligjvënësin. Një tjetër konsideratë është

nevoja për të siguruar se kompetencat e kontrollit, parandalimit dhe hetimit të krimit ushtrohen në një mënyrë e cila a respekton plotësisht procesin e drejtë dhe garanci të tjera që vendosin kufizime legjitime mbi krimin dhe i çojnë autorët e krimeve para drejtësisë, duke përfshirë garancitë e dhëna në nenin 8 dhe 10 të Konventës, garanci tek të cilat mund të bazohen dhe vetë autorët e krimit. Gjykata është e ndjeshme ndaj argumentit të Qeverisë që çdo mangësi legjislativ duhet të shihet në kuadrin social të kohës. Gjykata vëren kohën kur ndodhi incidenti, në vitin 1999, pra një kohë kur dihej se Interneti, posaçërisht për shkak të karakterit të tij anonim, mund të përdorej për qëllime kriminale (shih paragrafin 22 deri në 24 më lart). Po ashtu, dhe çështja e abuzimit seksual të fëmijëve ishte bërë e njohur që një dekadë më parë. Si rezultat, mund të thuhet se Qeveria e paditur nuk kishte krijuar një sistem për mbrojtjen e viktimave fëmijë nga të ekspozuarit si subjekte qasjesh pedofilie nëpërmjet Internetit.

49. Gjykata është e mendimit që mbrojtja praktike dhe efektive e kërkuarit kërkonte marrjen e masave efektive për të identifikuar dhe për të ndjekur autorin e krimi, i cili ishte personi që bëri njoftimin. Në çështjen në fjalë, kjo mbrojtje nuk u dha. Një hetim efektiv nuk mund të ndërmerrej për shkak të kërkesës mbizotëruese për konfidencialitet. Megjithatë liria e shprehjes dhe konfidencialiteti i komunikimeve janë konsiderata parësore dhe përdoruesit e shërbimeve të telekomunikacionit dhe Internetit duhet të jenë të garantuar për respektimin e privacisë dhe lirisë së tyre të shprehjes, këto garanci nuk mund të jenë absolute dhe duhet t'ia lënë vendin domosdoshmërive të tjera absolute, të tilla si mbrojtja nga mungesa e rregullit ose nga krimi, ose mbrojtja e të drejtave dhe e lirive të tjerëve. Pa prekur çështjen nëse sjellja e personit që botoi njoftimin ofendues në Internet mund të tërheqë mbrojtjen e nenit 8 dhe 10, duke pasur parasysh natyrën e tij negative, gjithsesi, mbetet detyrë e ligjvënësit të ofrojë kuadrin e nevojshëm për të trajtuar pretendimet e tjera që konkurrojnë për mbrojtje në këtë kuadër. Gjithsesi, një kuadër i tillë nuk ekzistonte në kohën materiale dhe rezultati ishte që detyrimi pozitiv i Finlandës në lidhje me kërkuarin nuk mund realizohej. Kjo mangësi u trajtua më vonë. Gjithsesi, mekanizmat e prezantuar nga Akti i Ushtrimit të Lirisë së Shprehjes në Mas Media (shih paragrafin 21 më lart) ishte shumë i vonë për kërkuarin.

50. Gjykata konstaton shkelje të nenit 8 në çështjen në fjalë.

51. Duke pasur parasysh konstatimet e lidhura me nenin 8, Gjykata është e mendimit që nuk është e nevojshme që të shqyrtojë nëse, në këtë çështje, ka pasur shkelje të nenit 13 (shih, ndërmjet të tjerash, *Sallinen dhe Të tjerët k. Finlandës*, nr. 50882/99, §§ 102 dhe 110, 27 shtator 2005, dhe *Copland k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 62617/00, §§ 50-51, GJEDNJ 2007-...).

II. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

52. Neni 41 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.

A. Dëmi

53. Nën zërin e dëmeve morale, kërkuesi kërkoi 3,500 euro (EUR) për vuajtjen e shkaktuar.

54. Qeveria u përgjigj që shpërblimi nuk duhet ta kalonte shumë prej 2,500 eurosh.

55. Gjykata e konstaton të bazuar vuajtjen e dëmeve morale nga kërkuesi. Ajo gjykon që shpërblimi i drejtë nuk ofrohet vetëm me konstatimin e shkeljes, por për këtë arsye duhet të jepet dhe dëmshpërblim. Duke vendosur në mënyrë të barabartë, Gjykata i jep kërkuesit 3,000 euro për këtë zë.

B. Kostot dhe shpenzimet

56. Kërkuesi kërkoi 2,500 euro për kostot e proceseve kombëtare dhe të proceseve para Gjykatës.

57. Qeveria shtroi pyetjen nëse kërkuesi i kishte paraqitur dokumentet e nevojshme.

58. Gjykata vëren se nuk është paraqitur asnjë dokument siç parashikohet në Rregullin 60 të Rregullores. Si rezultat, kërto kërkesa rrëzohen.

C. Interesi i munguar

59. Gjykata e mendon të arsyeshme që niveli i interesit të bazohet në nivelin bazë të huasë së Bankës Qendrore Evropiane, mbi të cilin duhet të shtohet tre përqind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA UNANIMISHT

1. *Vendos* se ka shkelje të nenit 8 të Konventës;

2. *Vendos* se nuk është e nevojshme të shpjegohet kërkesa sipas nenit 13 të Konventës;
3. *Vendos*
 - (a) që shteti i paditur t'i paguajë kërkuuesit, brenda tre muajsh pasi vendimi merr formë të prerë, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, 3,000 euro (tre mijë euro), plus çdo tatim që mund të duhet të paguhet mbi këtë shumë në lidhje me dëmin moral;
 - (b) që nga kalimi i afatit kohor prej tre muajsh të përcaktuar më lart deri në shlyerjen e plotë të paguhet interes i thjeshtë mbi shumën, bazuar në nivelin bazë të huasë të Bankës Qendrore Evropiane, plus tre përqind;
4. *Rrëzon* pjesën tjetër të kërkesës së kërkuuesit për shpërblim të drejtë.

Bërë në anglisht dhe e njoftuar me shkrim më 2 dhjetor 2008, në përputhje me rregullin 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Lawrence Early

Nicolas Bratza

Sekretar

President

© Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 2012.

Gjuhët zyrtare të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut janë anglisht dhe frëngjisht. Ky përkthim u krye me mbështetje të Fondit të Mirëbesimit të të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës (www.coe.int/humanrightstrustfund). Ai nuk është detyrues për Gjykatën, e cila nuk mban përgjegjësi për cilësinë e tij. Ai mund të shkarkohet nga HUDOC, baza e të dhënave të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (<http://hudoc.echr.coe.int>) ose nga çdo bazë tjetër të dhënash me të cilën Gjykata e ndan atë. Ai mund të riprodhohet për qëllime jo-komerciale, me kusht që të citohet titulli i plotë i çështjes, së bashku me të dhënat e mësipërme për të drejtën e autorit dhe referencën për Fondin e Mirëbesimit të të Drejtave të Njeriut. Për përdorimin e çdo pjese të këtij përkthimi për qëllime komerciale, ju lutemi të kontaktoni në adresën publishing@echr.coe.int.

© Council of Europe/European Court of Human Rights, 2012.

The official languages of the European Court of Human Rights are English and French. This translation was commissioned with the support of the Human Rights Trust Fund of the Council of Europe (www.coe.int/humanrightstrustfund). It does not bind the Court, nor does the Court take any responsibility for the quality thereof. It may be downloaded from the HUDOC case-law database of the European Court of Human Rights (www.coe.int/humanrightstrustfund) or from any other database with which the Court has shared it. It may be reproduced for non-commercial purposes on condition that the full title of the case is cited, together with the above copyright indication and reference to the Human Rights Trust Fund. If it is intended to use any part of this translation for commercial purposes, please contact publishing@echr.coe.int.

© Conseil de l'Europe/Cour européenne des droits de l'homme, 2012.

Les langues officielles de la Cour européenne des droits de l'homme sont le français et l'anglais. La présente traduction a été effectuée avec le soutien du Fonds fiduciaire pour les droits de l'homme du Conseil de l'Europe (www.coe.int/humanrightstrustfund). Elle ne lie pas la Cour, et celle-ci décline toute responsabilité quant à sa qualité. Elle peut être téléchargée à partir de HUDOC, la base de jurisprudence de la Cour européenne des droits de l'homme (www.coe.int/humanrightstrustfund), ou de toute autre base de données à laquelle HUDOC l'a communiquée. Elle peut être reproduite à des fins non commerciales, sous réserve que le titre de l'affaire soit cité en entier et s'accompagne de l'indication de copyright ci-dessus ainsi que de la référence au Fonds fiduciaire pour les droits de l'homme. Toute personne souhaitant se servir de tout ou partie de la présente traduction à des fins commerciales est invitée à le signaler à l'adresse suivante: publishing@echr.coe.int.